

BULETINI I AKTIVITETEVE

MAJI, MUAJI KUSHTUR ARSIMIMIT FINANCIAR

5.5.2021

"Arsimimi financiar është thelbësor për mbrojtjen e konsumatorëve. "

Edukimi financiar është një proces që duhet të mundësojë një kuptim më të mirë të produkteve financiare, koncepteve dhe rreziqeve, si dhe zhvillimin e aftësisë së popullatës për të bërë zgjedhje të përshtatshme dhe për të marrë vendime të duhura financiare dhe për të menaxhuar financat personale. Informacioni dhe një përgatitje më e mirë për të marrë vendime financiare të mençura dhe të duhura do të kontribuojnë në përfshirjen më të lartë financiare, respektivisht aksesin e personave juridikë dhe individëve në lloje të ndryshme të produkteve dhe shërbimeve financiare.

Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve (AMS) është organ i pavarur rregullator që rregullon tregun e sigurimeve, mbikëqyr punën e shoqërive të sigurimeve, kujdeset për mbrojtjen e të drejtave të të siguruarit/policëmbajtësit dhe kontribuon në edukimin financiar të popullsisë.

Më shumë në www.edukacija.aso.mk



7.5.2021



"Pikat kryesore të raportit për arsimim financiar"

Sipas matjes së parë kombëtare të nivelit të arsimimit financiar midis popullatës së moshës madhore në vendin tonë, në vitin 2018, niveli i arsimimit financiar është 11.8, sipas metodologjisë standarde të Rrjetit Ndërkombëtar për Edukimin Financiar. Ky është një nivel relativisht më i ulët krahasuar me mesataren e Grupit të 20 të vendeve më të zhvilluara në botë me 12.7 pikë, por është e krahasueshme me vendet në rajon.

Studimi u bë duke ekzaminuar tre komponentët më të rëndësishëm që janë pjesë integrale e arsimimit financiar: **njohuritë financiare, sjellja financiare dhe qëndrimet financiare.**

Konstatimet e sondazhit zbulojnë një përfshirje relativisht më të ulët të popullatës maqedonase kur bëhet fjalë për përdorimin e shërbimeve financiare dhe pagesa online. Lidhur me produktet dhe shërbimet financiare më të reja ose më të sofistikuara, ka më pak ndërgjegjësimit në mesin e popullatës në krahasim me njohuritë në lidhje me produktet klasike, ndërsa në shumicën e produkteve dhe shërbimeve financiare, edhe pse ndërgjegjësimi është solid, përdorimi është në mënyrë të konsiderueshme më i ulët.

Më shumë në linkun <https://edukacija.aso.mk/wp-content/uploads/2019/07/Adult-Financial-Literacy-Competencies-in-Macedonia-2017.pdf>



11.5.2021 година

Për tre muajt e parë të këtij viti, në AMS janë dorëzuar 36 ankimime nga policëmbajtës ose persona të siguruar që nuk janë të kënaqur me punën e shoqërive të sigurimeve nga të cilat kanë blerë policat e sigurimeve.

<https://aso.mk/.../ams-numri-i-ankimimeve-nga.../>



12.5.2021

Mbrojtja e të siguarve/policëmbajtësve

Mbrojtja e konsumatorit përfshin: sigurimin e informacionit të saktë dhe në kohë për konsumatorët për vendime të informuara, mosekzistimin e praktikave të padrejta dhe mashtruese në kontrata, si dhe aksesin në mekanizmat për zgjidhjen e shkeljeve të të drejtave të konsumatorit.

<https://edukacija.aso.mk/%d0%bf%d0%be%d0%b4%d0%bd%d0%b5%d1%81%d0%b8-%d0%bf%d1%80%d0%b5%d1%82%d1%81%d1%82%d0%b0%d0%b2%d0%ba%d0%b0/>

<https://edukacija.aso.mk/%d0%be%d1%81%d0%b8%d0%b3%d1%83%d1%80%d1%83%d0%b2%d0%b0%d1%9a%d0%b5/>



13.5.2021

Stimulimi i mendimit shkencor

Me qëllim për të stimuluar zhvillimin e mendimit shkencor dhe përgatitjen e kërkimeve studimore në fushën e menaxhimit të rrezikut dhe të sigurimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, si dhe afirmimin e profesionistëve të rinj, Agjencia e Mbrojtjes së Sigurimeve do të ndajë çmimin vjetor për vitin 2021 për punim studimor në fushën e menaxhimit të rrezikut dhe të sigurimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

<https://bit.ly/2Rd11Z0>



14.5.2021

Auto-Përgjegjësia (AP) është mbulim për përgjegjësinë tuaj nëse shkaktoni dëm gjatë pjesëmarrjes në trafik.

Është e paligjshme të drejtosh automjetin tënd të pasiguruar!

Polica e blerë është shumë herë më e lirë dhe zgjidhje më e sigurt në krahasim me koston që do të duhet të paguani nëse drejtoni një automjet të pasiguruar dhe të paregjistruar!!!

Primi është çmimi që paguani për një policë të sigurimit të përgjegjësive automatike. Ky çmim varet nga:

- mosha e shoferit;
- nga fuqia e motorit të automjetit për të cilin është blerë;
- sa shofer shembullor dhe i ndërgjegjshëm jeni;

Ju mund të blini një policë auto-përgjegjësie nga: shoqëria e sigurimeve, përfaqësuesi i sigurimeve dhe shoqëritë e brokerimit në sigurime.

Vitin e kaluar, 11 shoqëri të sigurimeve shitën politca të auto-përgjegjësive. Në vitin 2020, janë shitur mbi 600,000 polica me një vlerë totale prej 80.65 milionë euro.

Më shumë rreth sigurimit të auto-përgjegjësive mund të lexoni në linkun vijues

<https://edukacija.aso.mk/wp-content/uploads/2015/12/AvtoOdgovornost-Flaer-MK-Final-zz.pdf>



AGENCIJA E
MBROJTËSISË
E SIGURIMEVE

MUAJI I EDUKIMIT
DHE ARSIMIMIT
FINANCIAR

**AUTO-PËRGJEGJËSIA ËSHTË MBULIMI
JUAJ NËSE SHKAKTONI DËM NË TRAFIK**

19.5.2021


Rritet sigurimi bujqësor

A e dini se investimi në sigurimet bujqësore po rritet për pesë vjet me radhë? Dhe që vitin e kaluar fermerët dhe blegtorët investuan mbi tetë milionë euro në polica dhe arkëtuan mbi 5 milionë euro nga dëmet në bujqësi dhe blegtori?

Ndryshimi i klimës po ndikon negativisht në të korrat dhe të mbjellat. Ne nuk mund t'a ndalojmë këtë shpejt dhe lehtë, por mund të neutralizojmë rrezikun e katastrofave të motit të shkaktuara nga ndryshimi i klimës. Si? Ne do të sigurojmë prodhimin bujqësor! Dhe ne do të përdorim mundësinë për të subvencionuar 60 për qind të kostos së policës së siguruar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujit.

Lexoni më shumë në linkun vijues

<https://edukacija.aso.mk/wp-content/uploads/2015/12/Brosura-zemjodelstvo.pdf>



21.5.2021 година

A e dini se brokeri i sigurimeve mbron të drejtat tuaja në marrëdhëniet me kompaninë e sigurimeve nga e cila blini një policë sigurimi.

Ndër detyrat e tij më të rëndësishme janë këto:

- t'ju ofrujë mbulim adekuat të sigurimit
- të ndërmjetësojë në emrin tuaj dhe propozon opsionin me mbulimin më të përshtatshëm
- kontrollon përmbajtjen e policës së sigurimit

- në rast dëmtimi, bëni kujdes të veçantë për të vepruar brenda afateve të dhëna kohore, të cilat janë parakusht për të fituar të drejtat nga policat e sigurimit

Lexoni më shumë në linkun vijues

<https://edukacija.aso.mk/>



26.5.2021

Informimi i të siguruarve/policëmbajtësve gjatë lidhjes së kontratave të sigurimit

Detyrimi për të informuar të siguruarin si persona fizikë, konsumatorët, kur lidhin kontratën e sigurimit, duhet të jetë me shkrim dhe të përmbajë informacion mbi:

emrin, statusin juridik, selinë dhe adresën e shoqërisë së sigurimeve përmes së cilës është lidhur kontrata e sigurimit, kushtet e përgjithshme dhe të posaçme të policës të zbatueshme për të siguruarin, periudhën e vlefshmërisë së kontratës së sigurimit, mënyrën e paraqitjes së ankesës, respektivisht ankimit, mënyrën e parashtrimit të kërkesës për dëmshpërblim etj.

Lexoni më shumë në linkun vijues: <https://bit.ly/33W5TFY>



ÇFARË ËSHTË E RËNDËSISHME TË DINI
PARA SE TË BLINI NJË KONTRATË SIGURIMI (POLICË)?

26.5.2021 година

Mbyllja e ciklit edukativ - Njohuri financiare me Shkollën e Mesme "Dren"

Mbyllja e ciklit edukativ Bazat e arsimimit financiar, sigurimi dhe kompetencat e Agjencisë së Mbiqëqyrjes së Sigurimeve. Ndarja e diplomave nxënësve nga grupi/drejtimi financiar i shkollës "Vasil Antevski DREN".



28.5.2021

Të gjithë duam të udhëtojmë jashtë! Në çdo mundësi: privatisht ose zyrtarisht, me pushime ose për biznes. Pse nevojitet sigurimi i shëndetit në udhëtim? Sigurimi i shëndetit në udhëtim mbulon një

numër rreziqesh të mundshme, përfshirë mbulimin e kostove të kujdesit shëndetësor që ndodhën në mënyrë të paplanifikuar gjatë udhëtimit ose kompensimin e bagazhit të humbur dhe të vjedhur.

Lexoni më shumë në linkun vijues:<https://edukacija.aso.mk/wp-content/uploads/2015/12/Patnicko-Flaer-MK-16.10.2015.pdf>

